



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

**SHPLLJE PËR EKSPERT/KËSHILLTAR  
PËR KONCEPTIMIN DHE REALIZIMIN E NJË EKSPOZITE DHE BOTIMI ME  
PROFILE TË DEPUTETËVE, ME TEKSTE TË DEDIKUARA BAZUAR NË  
DOSJET ARKIVORE PËR DEPUTETËT, NË KUADËR TË PËRKUJTIMIT TË 76-  
VJETORIT TË EKZEKUTIMIT.**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit  
Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar**

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar), Neni 36, pika 6 “Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontraktojë ekspertë të jashtëm”, të Vendimit të Autoritetit për Informim me nr. 424, datë 27/09/2022, me objekt “Për procedurën që do të ndiqet për kontraktimin e ekspertëve/këshilltarëve vendas apo ndërkombëtarë në bazë të ligjit 45/2015, i ndryshuar”, të Vendimit të Autoritetit për Informim me nr. 542, datë 04/09/2023, me objekt “Kontraktimi i një eksperti/këshilltari për konceptimin dhe realizimin e një ekspozite dhe botimi me profile të deputetëve, me tekste të dedikuara bazuar në dosjet arkivore për deputetët, në kuadër të përkujtimit të 76-vjetorit të ekzekutimit të tyre”, si dhe VKM nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”,

shpall Procedurat për kontraktimin e **ekspertit/këshilltar për konceptimin dhe realizimin e një ekspozite dhe botimi me profile të deputetëve, me tekste të dedikuara bazuar në dosjet arkivore për deputetët, në kuadër të përkujtimit të 76-vjetorit të ekzekutimit:**

**Kategoria e pagës referuar VKM-së 325/2023, pika 4.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**12/09/2023**

## 1- Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Autoritetit, konkretisht të Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, eksperti i kualifikuar do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Hulumtime arkivore dhe përpunim të dhënash në fushën e dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit për grupin e deputetëve, të pushkatuar dhe dënuar nga regjimi komunist më 10 tetor 1947.
- Përgatitjen e një materiali studimor dhe realizimin e profileve të grupit të deputetëve.
- Mbështetje në organizimin e një aktiviteti/ekspozite përkujtimore për datën 10 tetor 2023, në komunikimin me grupet e interesit dhe të afërmve.
- Koordinimin dhe komunikimin me institucionet që operojnë në fushën e kujtesës për hulumtimin e studimeve të mëparshme sa i takon ngjarjes së tetorit 1947, atyre që i paraprinë dhe pasojave.

### Rezultatet e pritshme:

1. Organizimin e punës, konceptimin dhe realizimin e një ekspozite me profile të deputetëve, me tekste të dedikuara, bazuar në dosjet arkivore për deputetët, imazhe dokumentare e fotografike, si edhe rrëfimet e të njohurve/familjarëve që janë gjallë ose atyre që kanë lënë dëshmi të shkruara, duke u mbështetur edhe në studime të mëparshme nëse ka.
2. Shqyrtimin e dosjeve hetimore dhe gjyqësore ose dokumentacion tjetër që disponohet për deputetët e që ruhet pranë Autoritetit për Informim mbi Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për të zbardhur akuzat, hetimet, dëshmitë dhe procesin përmes të cilit u dënuan deputetët.
3. Kontaktimin, intervistimin dhe koordinimin me përfaqësues të familjarëve të tyre, grupeve të interesit dhe institucioneve të tjera që operojnë në fushën e kujtesës në vend, sa i takon veprimtarisë dhe studimeve mbi deputetët, aktiviteteve ose botimeve për ta dhe fatin e familjeve të tyre gjatë regjimit komunist.
1. Hulumtime në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe në Bibliotekën Kombëtare mbi letërkëmbime institucionale të vitit 1947, para dhe pas dënimit të deputetëve dhe pasqyrimin e ngjarjes në shtypin e kohës.
4. Konceptimin dhe rishikimin e teksteve të profileve të deputetëve në mbështetje të misionit të Autoritetit, ku perfshihet dhe mbajtja e marrëdhënieve me dizajnerin dhe ndjekja e ndërtimit të ekspozitës, në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë.
2. Mbajtjen e komunikimit të rregullt me Autoritetin dhe drejtorinë përgjegjëse, për mbarëvajtjen e ekspozitës, pasurimin me të dhëna të ekspozitës dhe përcjelljen e raporteve mbi ecurinë e saj.

3. Mbështetjen e organizimit të një aktiviteti nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit në tetor 2023, në përkujtim të ekzekutimeve të deputetëve.

<b>Fazat e punës:</b>
Organizimi i tryezave të diskutimeve me Autoritetin dhe grupet e interesit
Shqyrtimi i dokumentacionit në Autoritet dhe arkiva të tjera
Drafti i parë i profileve
Drafti final i profileve dhe Ekspozitës
Koordinimi me dizenjuesin dhe produkti përfundimtar
Raport mbi punën e kryer për projektin

**Për Pozicionin, kandidatët e interesuar duhet:**

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” në fushën e jurisprudencës, të drejtës ndërkombëtare, komunikimit dhe shkencave humane (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë të paktën 10 vjet përvojë pune.
3. Të kenë eksperiencë pune konkrete në fushën e kërkimit, të drejtave të njeriut, përpunimit të strategjive, hartimit të materialeve udhëzuese, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun;
4. Të zotërojnë gjuhën angleze, të folur e të shkruar dhe të prezantimit në shqip dhe anglisht. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
5. Të plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”
6. Të kenë aftësi për të komunikuar me ekspertë dhe personel të angazhuar në profile të ndryshme profesionale.
7. Të kenë aftësi për të formuluar njoftime për shtyp, përmbledhje narrative, kërkesa për informim, abstrakte dhe shkrime informative.
8. Të kenë njohuri dhe aftësi për të ndjekur aktualitetin, për të komunikuar me ekspertë, përfaqësues të medias dhe aktorë të tjerë.

Shtuar kritereve me lart, personi i interesuar duhet të ketë integritet dhe motivim për çështje që lidhen me informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të shkuarën komuniste në Shqipëri, si dhe:

- Njohuri të thella në çështjet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit;
- Entuziazëm dhe korrektësi: Aftësi për të punuar në mënyrë efektive nën afate të ngushta dhe ngarkese të konsiderueshme pune;
- Puna në grup: Aftësi e dëshmuar për të punuar në bashkëpunuar, për të përmbushur qëllimet e projektit, duke mbajtur marrëdhënie efektive multidisiplinare dhe duke kultivuar kulturën e shkëmbimit të informacionit dhe njohurive në grup;
- Aftësitë personale: Aftësia për të komunikuar lehtësisht dhe mirë me stafin në të gjitha nivelet dhe gjithashtu me homologët e jashtëm;
- Planifikimi dhe rezultatet: Aftësi për të planifikuar rezultatet e projektit; Aftësi për të monitoruar performancën në respektim të afateve;
- Mbani fokusin në rezultate; kapërceni pengesat dhe sfidat,
- Kompetencë e lartë në komunikim dhe aftësi për të shkruar dokumente të një natyre teknike;

## **2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- b- Jetëshkrim i plotësuar;
- c- Fotokopje të diplomës së masterit;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 12/09/2023.***

## **3. NJOHURITË MBI LEGJISLACIONIN TË CILAT DUHET TË KETË KANDIDATI:**

---

Njohuritë mbi legjislacionin të cilat duhet të ketë kandidati:

- a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”;
- b) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- c) Njohuri Mbi Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- g) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- h) Njohuri mbi Ligjin Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”;

#### **4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

##### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

##### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

#### **5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Autoritetit, <http://autoritetidosjeve.gov.al/>. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

